



REPUBLIKA E SHQIPERISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**REKTORATI**  
**DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE**

Nr. 1215 Prot.

Tiranë, më 13/05 /2024

**Lënda:** Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës.

**FAKULTETIT TË INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE**  
**FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**  
**FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
**FAKULTETIT TË GJEOLOGJISË DHE MINIERAVE**  
**FAKULTETIT TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT**  
**FAKULTETIT TË INXHINIERISË ELEKTRIKE**  
**FAKULTETIT TË INXHINIERISË MEKANIKE**  
**INSTITUTIT TË GJEOSHKENCAVE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, urdhrin nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës të miratuar me vendimin nr. 10, datë 28.03.2024 të Senatit Akademik, neni 5, pika 3, si dhe urdhrin nr. 37, datë 13.05.2024 të Rektorit “Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës”, ju njoftojmë fillimin e procesit zgjedhor në datën 21.05.2024 dhe zhvillimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në datën 21.06.2024.

Bazuar në nenin 6 të rregullores, për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor ngrihet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ). Komisioni përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, 8 (tetë) anëtarë përfaqësues nga çdo njësi kryesore e UPT, si dhe 1 (një) anëtar përfaqësues i studentëve.

Regjistrimi i kandidatëve për anëtarë të KIZ bëhet në Sekretarinë e Senatit Akademik (në Drejtorinë e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në Rektorat) brenda datës 16.05.2024. Orari për dorëzimin e kërkesës për aplikim është 10:00 – 14:00.

Për sa më sipër, të merren masat për njoftimin e personelit akademik të njësisë kryesore, si dhe studentëve të interesuar për aplikimin dhe regjistrimin në sekretarinë e Senatit Akademik për kandidatë në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve, brenda afatit të përcaktuar.

Bashkëlidhur gjeni një kopje të urdhrit nr. 37, datë 13.05.2024 të Rektorit “Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**REKTORI**

**Prof. Dr. Andrea Maliqari**





REPUBLIKA E SHQIPERISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**REKTORATI**

**DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE**

Nr. 12/5 Prot.

Tiranë, më 13/05/2024

**URDHËR**

Nr. 37, datë 13/05/2024

**PËR**

**SHPLLJEN E FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", urdhrin nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", si dhe Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës" neni 5, pika 3,

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Data e fillimit të procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, është data 21.05.2024.
3. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, është data 21.06.2024.
4. Ngarkohen Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike, si dhe njësitë kryesore, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Andrea Malajari

